

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhvedet Abazi, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Fillim Skoro, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.K.,nga fshati ... ,K.Kamenice, për shkak të veprës penale mbajta në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.242/17 të datës 27.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **21.shtator 2018**, mori këtë:

## AKT GJYKIM

**REFUZOHET** si e **pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.242/17 të datës 27.06.2018, **VËRTETOHET**.

## Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.242/17 të datës 27.06.2018, i akuzuari M.K., ne bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së është liruar nga akuza në mungesë të provave për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi kontroll posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjithashtu është vendosur që shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë çështje penale të bien në mjetet buxhetore të gjykatës.

Policia e Kosovës është urdhëruar që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t'ia kthej të akuzuarit armën e konfiskuar pushkën e gjuetisë e tipit M-48 me nr. serik 95580 e kalibrit 7.9 mm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan te anuloje dhe çështjen ti: a kthej Gjykatës se shkalles se pare ne rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka bërë mbrojtësi i të akuzuarit M.K. – av. Sh.P. nga Gjilani, i cili ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, me shkresën e vet PPA.I.nr.362/18 të datës 24.08.2018 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan ta aprovoj si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, si dhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe gjeti se:

#### **-Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtën e vlerësuar edhe në këtë aspekt dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPK-së të cilat kjo gjykatë i konstaton sipas detyrës zyrtare e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimin.

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike nga neni 386 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, Prokuroria Themelore në Gjilan me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike ashtu që nga një gjendje e tillë e vërtetuar gabimisht ka vepruar kur ka nxjerrë aktgjykim lirues edhe pse në periudhën kur të akuzuarit i është konfiskuar arma – pusha e gjuetisë e prodhim M-48 i njëjti nuk ka pas leje për mbajtjen e saj por vetëm të aplikuar për leje me datë 20.11.2013 në Ministrinë e Punëve të Brendshme për vazhdimin e lejes dhe në janar të vitit 2017 është pajisur me vazhdimin e lejes, pra gjatë vitit 2016 kur i është konfiskuar pushka i njëjti nuk ka pasur leje.

Gjykata e Apelit ka bërë vlerësimin e pretendimeve ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe pas vlerësimit të njëjtës konstaton se ankesa nuk është e bazuar dhe se gjendjen e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të drejtë dhe të ligjshme edhe Gjykata e Apelit.

Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit gjyqësorë pas dëgjimit të akuzuarit M.K. si dhe administrimit të provave materiale si kërkesa të akuzuarit e datës 20.11.2013, për vazhdimin e lejes për mbajtjen e armës, lejes së leshur për mbajtjen e armës nga Ministria e Punëve të Brendshme në janar të vitit 2017, certifikatës së lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me kalimin e provimit profesionale dhe testit teorik – praktik për mbajtjen dhe përdorimin e armëve të gjata, anëtarësimin në Shoqatën e Gjuetarëve “Kriva Reka” si dhe duke u bazuar në Ligjin mbi Armët me nr. 3/L143 i cili ka qenë në fuqi në kohën e kërkesës për vazhdimin e lejes nga i akuzuari, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale mbajta në pronësi, kontroll posedim të paautorizuar të armëve nga neni

374 par. 1 të KPRK-së për të cilën ka qenë i akuzuar nga se në periudhën sa ka qenë pa leje Ministria e Punëve të Brendshme ka qenë e obliguar t'ia konfiskoj armën e sikur i njëjti kishte mbajtur në mënyrë kundërligjore nuk do t'ia kishte lëshuar lejen në vitin 2017.

Pra Gjykata e Apelit gjeti se ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan nuk është e bazuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.384/18, më 21.09.2018**

**Procesmbajtës**  
**Eroll Gashi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetari i kolegjit,**  
**Xhevdet Abazi**

---

**Fillim Skoro**

---